# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8202
E enjte, 11 dhjetor 2025
Çmimi 0. 50 €


## Bedri Hamza kërkon rol aktiv të ShBA-së në procesin e dialogut

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# GJYKATA SPECIALE E LIRON ME KUSHT ISNI KILAJN



Të mërkurën e 10 dhjetorit Isni Kilaj është liruar me kusht nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Sipas njoftimit për medie, vendimi për lirimin me kusht është marrë më 3 dhjetor. Gjykatësi ka vlerësuar se rrethanat kanë ndryshuar dukshëm që nga rishikimi i fundit i paraburgimit në tetor, duke konstatuar se vazhdimi i mbajtjes së Kilajt në paraburgim nuk është më i arsyeshëm dhe as proporcional. Në vendimin e Speciales përcaktohet se në qoftë se Kilaj do të shkelë cilindo prej kushteve të lirimit të tij, do të lëshohet një fletarrestim për arrestimin e tij të menjëhershëm

## PRESIDENTI BEGAJ: MOMENTUMI HISTORIK I SHQIPËRISË DREJT BE-SË FORCON EDHE POZITËN NDËRKOMBËTARE TË KOSOVËS

F. 3



## DËSHTON NISJA E GJYKIMIT PËR REZERVAT SHTETËRORE

F. 3



## OPINION

### 50-VJETORI I ASHAK-ut: THEMELIMI I KËTIJ INSTITUCIONI PESË DEKADA MË PARË SHËNOI NJË MOMENT HISTORIK

F. 6

Akademik
Arsim BAJRAMI



## AKTUALE



### NISIN NEGOCIATAT PËR NJË MARRËVESHJE DYPALËSHE MES SHBA-së DHE MALIT TË ZI

F. 2

### RIKTHIMI I QYTETARËVE NGA ZONAT E KONFLIKTIT, KOSOVA TREGON PËRVOJËN NË BRUKSEL

F. 6

## EKONOMI



### FESTAT E SHTRENJTA: ÇMIMET RRISIN BARRËN PËR FAMILJET E KOSOVËS

F. 8

## SPORT

### DUELE TË FORTA NË 1/8 E KUPËS SË KOSOVËS

F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# NISIN NEGOCIATAT PËR NJË MARRËVESHJE DYPALËSHE MES SHBA-së DHE MALIT TË ZI

PODGORICË, 10 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mali i Zi po nisin negociatat për arritjen e një marrëveshje dypalëshe që ka për qëllim forcimin e lidhjeve tregtare, investuese dhe ekonomike, njoftoi Ambasada Amerikane në Podgoricë më 10 dhjetor.

Negociatat do të zhvillohen në kuadër të Dialogut Ekonomik ShBA-Mali i Zi 2025. "ShBA-ja njihet globalisht për inovacionin dhe besueshmërinë ekonomike, ndërsa kompanitë amerikane po tregojnë interes gjithnjë e më të madh për mundësitë e biznesit në ekonominë në rritje të Malit të Zi", thuhet në njoftimin e Ambasadës.

Sipas saj, qëllimi i këtyre negociatave është të nxisin investime më të mëdha të sektorit privat amerikan për të krijuar vende të reja pune në ShBA dhe në Mal të Zi, ta forcojnë rolin e Malit të Zi si aleat i NATO-s dhe të hapin mundësi të reja për prosperitetin e ShBA-së, Malit të Zi dhe rajonit më të gjerë.

Në nëntë muajt e fundit Mali i Zi ka nënshkruar katër marrëveshje ndërshtetërore, me Francën, Hungarinë dhe dy me Emiratet e Bashkuara Arabe.

Të gjitha këto kanë karakter ndërshtetëror që lejon përzgjedhjen e kontraktorëve pa tenderë publikë.

Marko Soshiq nga Instituti Alternativa më herët i ka thënë Radios Evropa e Lirë se ky ritëm i nënshkrimit të marrëveshjeve është rezultat i detyrimit të qeverisë që të gjithë marrëveshjet ndërshtetërore të Malit të Zi, nga 26 dhjetori, duhet të harmonizohen me rregullat e Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit publik.

Kjo është një pikë nga agjenda e reformave në negociatat e anëtarësimit të Malit të Zi me BE-në.

Marrëveshjet me Emiratet kanë të bëjnë me turizmin, pasuritë e paluajtshme, energjinë dhe teknologjitë digjitale. Marrëveshja me Hungarinë fokusohet tek infrastruktura e transportit, digjitale dhe teknologjisë informative. Ndërsa ajo me Francën është një kombinim i projekteve infrastrukturore, energjetike dhe digjitale.

Qeveria e Malit të Zi thotë se bëhet fjalë për partneritete strategjike për "zhvillim më të shpejtë dhe tërheqje investimesh" që duhet ta ulin burokracinë dhe ta rrisin efikasitetin.

Ligji malazez për prokurimet publike lejon zgjedhjen e partnerëve të biznesit pa tender. "Këto rregulla nuk zbatohen për prokurimet publike që realizohen në përputhje me rregullat e posaçme të një marrëveshjeje ndërkombëtare në mes të Malit të Zi dhe një ose më shumë shteteve anëtare të BE-së, ose vendeve të treta", që lidhet me projekte të interesit të përbashkët.

Parashihet, gjithashtu, që qeveria malazeze ta njoftojë Komisionin Evropian për çdo marrëveshje të tillë ndërkombëtare.



Organizatat joqeveritare paralajmërojnë se kështu minohet sistemi i prokurimeve publike, që është një nga shtyllat e kontrollit të korrupsionit.

Marko Soshiq nga Instituti Alternativa tha për REL-in në nëntor se këto lloje të marrëveshjeve ndërshtetërore bartin rreziqe të mëdha pikërisht për shkak të përjashtimit të legjislacionit kombëtar. Ai vlerësoi se qeveria kërkon me to rrugë të shkurtra drejt investimeve, pasi zbatimi i buxhetit kapital apo propozimi i projekteve për financim nga BE-ja janë të ndërlikuara dhe të vështira.

Në raportin e fundit të Komisionit Evropian të nëntorit të këtij viti, përmendet vetëm marrëveshja e parë që Mali i Zi nënshkroi me Emiratet. Aty paralajmërohet se Mali i Zi duhet të sigurojë që zbatimi i kësaj dhe marrëveshjeve të ngjashme të mos jetë në kundërshtim me ligjet e BE-së për prokurimet publike.

Në raport u tha, po ashtu, se mënyra se si do të interpretohet, zbatohet dhe realizohet marrëveshja do të jetë nën vëzhgim të kujdesshëm të BE-së.

# POLONIA SYNON T'I KËMBEJË AVIONËT SOVJETIKË ME DRONËT UKRAINAS



VARSHAVË, 10 DHJETOR - Polonia planifikon t'ia japë pjesën e mbetur të aeroplanëve luftarakë MiG-29, të epokës sovjetike, Ukrainës në këmbim të teknologjisë për dronët, tha Ministria e Mbrojtjes më 10 dhjetor.

Polonia ka zëvendësuar aeroplanët e saj të vjetër sovjetikë me avionë F-16 të prodhimit amerikan dhe FA-50, të prodhimit të Koresë së Jugut, dhe pret dorëzimin e 32 aeroplanëve F-35 që ka porositur në ShBA. "MiG-ët po arrijnë fundin e shërbimit të tyre, që do të thotë se do të tërhiqen nga ushtria polake dhe ne po diskutojmë për transferimin e tyre në palën ukrainase", tha ministri i Mbrojtjes, Wladyslaw Kosiniak-Kamysz, për radion publike polake, Trojka.

Sipas Kosiniak-Kamysz, ky këmbim mund të përfshijë "transferimin e teknologjive, për shembull në fushën e dronëve dhe raketave nga Ukraina në Poloni".

Polonia, e cila i ka dhënë shumë nga avionët e saj MiG-29 Ukrainës pasi Moska nisi pushtimin e shtetit fqinj, ende ka edhe 14 avionë të tillë, sipas raporteve mediale. "Bisedimet po vazhdojnë, dhe jemi të vendosur t'i finalizojmë sa më shpejt të jetë e mundur", theksoi Kosiniak-Kamysz.

Ai shtoi se Polonia po përfiton tashmë nga ekspertiza ukrainase në trajnimin ushtarak për dronë. "Ukrainasit janë më të mirët sa iu përket dronëve në mesin e të gjitha vendeve me të cilat kemi marrëdhënie të mira".

Polonia, anëtare e Bashkimit Evropian dhe NATO-s, është ndër mbështetëset më të fuqishme të Ukrainës, duke shërbyer si qendër për dërgesat ushtarake dhe humanitare drejt Kievit.

## Koreja e Jugut me notë proteste pas inkursionit nga Kina dhe Rusia

Seul, 10 dhjetor - Koreja e Jugut tha se ka dorëzuar notë proteste te përfaqësuesit e Kinës dhe Rusisë më 10 dhjetor, një ditë pasi Seuli tha se aeroplanët ushtarakë të këtyre shteteve hynë në zonën e tij të mbrojtjes ajrore.

Seuli tha se ankesa iu dorëzua atasheve të mbrojtjes të dy shteteve që gjenden në kryeqytetin e Koresë së Jugut. "Ushtria jonë do të vazhdojë të përgjigjet në mënyrë aktive ndaj aktiviteteve të aeroplanëve të shteteve fqinje brenda KADIZ-it, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare", tha Lee Kwang-suk, drejtor i përgjithshëm i Byrosë të Politikave Ndërkombëtare në Ministrinë e Mbrojtjes të Seulit, duke iu referuar Zonës së Identifikimit të Mbrojtjes Ajrore të Koresë.

Koreja e Jugut tha të martën se kishte dislokuar "aeroplanë luftarakë për të ndërmarrë masa taktike në përgatitje të çdo situate" në përgjigje të inkursionit kinez dhe rus në KADIZ.

Aeroplanët u detektuan para se të hynin në KADIZ, që përshkruhet si një zonë e gjerë ku shtetet monitorojnë avionët e tyre për arsye sigurie, por që nuk përbën hapësirën e tyre ajrore.

Pekini më vonë konfirmoi se kishte organizuar stërvitje me ushtrinë e Rusisë në përputhje "me planet vjetore të bashkëpunimit".

Ndërkaq, Moska i përshkroi si stërvitje rutinë, duke shtuar se ato zgjatën tetë orë dhe disa aeroplanë të huaj luftarakë ndoqën aeroplanët rusë dhe kinezë.

Që nga viti 2019 Kina dhe Rusia vazhdimisht kanë fluturuar aeroplanët e tyre ushtarakë në zonën e mbrojtjes ajrore të Koresë së Jugut pa njoftim paraprak, duke thënë se po kryenin stërvitje të përbashkëta.



Nëntorin e vitit të kaluar Seuli ngriti në ajër aeroplanët pasi pesë aeroplanë ushtarakë kinezë dhe gjashtë rusë fluturuan përmes zonës së tij të mbrojtjes ajrore.

Incidente të ngjashme kishin ndodhur edhe në qershor dhe dhjetor të vitit 2023 si dhe në maj dhe nëntor të vitit 2022.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Presidenti Begaj: Momentumi historik i Shqipërisë drejt BE-së forcon edhe pozitën ndërkombëtare të Kosovës

Prishtinë, 10 dhjetor - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të mërkurën në takim presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin e pandalshëm dhe nevojën që Kosova dhe Shqipëria të jenë gjithmonë pranë njëra-tjetrës. "Në një takim të ngrohtë në fundvitit, sot pata kënaqësinë ta pres presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, me të cilin biseduam për bashkëpunimin tonë të pandalshëm dhe nevojën që Kosova dhe Shqipëria të jenë gjithmonë pranë njëra-tjetrës. Në prag të festave të fundvitit, i përcolla urimet më të përzemërta, me dëshirën që viti që vjen të sjellë edhe më shumë afërsi, më shumë bashkëpunim dhe hapa të suksesshëm drejt Bashkimit Evropian për dy shtetet tona", ka thënë Osmani pas takimit.
Edhe presidenti Begaj ka njoftuar për këtë vizitë në Kosovës, duke theksuar se momentumi historik i Shqipërisë drejt BE-së forcon edhe pozitën ndërkombëtare të Kosovës. "Gjatë vizitës në Kosovë, në 50-vjetorin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve u mikprita nga presidentja Vjosa Osmani. Rikonfirmuam bashkëpunimin e palëkundur Shqipëri - Kosovë dhe rëndësinë e projekteve të përbashkëta zhvillimore. Momentumi historik i Shqipërisë drejt BE-së forcon edhe pozitën ndërkombëtare të Kosovës", ka shkruar Begaj në "Facebook".



# DËSHTON NISJA E GJYKIMIT PËR REZERVAT SHTETËRORE

Prishtinë, 10 dhjetor - Në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka dështuar të mbahet seanca fillestare për rastin e rezervave shtetërore, ku në cilësinë e së akuzuarës është edhe ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari.
Nisja e procesit gjyqësor dështoi të mërkurën për shkak se Hajdari dhe avokati i të akuzuarit tjetër, Irfan Lipovica, nuk ishin të pranishëm, raporton "Betimi për Drejtësi".
Tani shqyrtimi fillestar është caktuar që të mbahet më 13 janar 2026.
Kryetari i trupit gjykues, Avni Syla, tha se Hajdarit i është dërguar ftesa për pjesëmarrje përmes postës, por deri më sot nuk ka marrë përgjigje nëse ajo e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt. Në seancë ishte i pranishëm ishte avokati i saj, Florent Latifaj.
I pranishëm ishte edhe Lipovica, kurse mungoi avokati i tij Feim Alaj. Avokati e dërgoi një përfaqësuese ligjore nga zyra e tij dhe ka njoftuar Gjykatën përmes e-mailit se nuk mund të ishte i pranishëm pasi paraprakisht kishte marrë ftesë nga Gjykata Themelore në Pejë.
Kreu i trupit gjykues tha se Themelorja përmes një e-maili i ka kërkuar Alajt që të gjejë zëvendësim, por ai ishte përgjigjur se kishte tentuar që të gjejë një avokat zëvendësues, mirëpo nuk e ka marrë pëlqimin e të mbrojturit të tij.
Të pranishëm në seancën e sotme që dështoi të zhvillohej ishte edhe i pandehuri tjetër Hafiz Gara me avokatin Nazim Mehmeti dhe i akuzuari Ridvan Muharremi me avokatin Mahmut Halimi.



### Aktakuza për rezervat shtetërore

Aktakuza ndaj Hajdarit u ngrit më 11 nëntor nga Prokuroria Speciale e Kosovës, e cila e akuzon atë për keqpërdorim të rezervave shtetërore.
Hajdari dhe dy zyrtarët Irfan Lipovica dhe Hafiz Gara, sipas Prokurorisë, dyshohen se në bashkëkryerje i kanë keqpërdorur detyrat zyrtare me qëllim që të përfitonin pasuri për persona të tjerë dhe i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës gjatë muajve shkurt dhe mars 2022.
Aktakuza pretendon se buxheti i shtetit ka pësuar një dëm prej rreth 3 milionë eurove si pasojë e veprimeve të të akuzuarve. Ata dyshohet se asokohe kishin blerë një sasi vaji dhe një sasi gruri jashtë vendit, që nuk kishin arritur kurrë në Kosovë.
Që të tre akuzohen për kryerjen e veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtare.
Ndërsa i akuzuari i katërt, Ridvan Muharremi, dyshohet për ndihmë në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar.
Hajdari, Lipovica dhe Gara akuzohen, po ashtu, se pa autorizim kanë zbuluar fshehtësinë zyrtare. Ministrja në detyrë, Rozeta Hajdari, e ka cilësuar si "tendencë politike" ndaj qeverisë së kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, aktakuzën e ngritur kundër saj dhe tre të tjerëve për rastin e rezervave shtetërore.

### Rezervat shtetërore

Më 2023 tre persona u arrestuan për rastin e rezervave shtetërore, përfshirë Garën, drejtor i Departamentit të Rezervave Shtetërore, dhe Lipovicën, drejtor i Departamentit për Integrime Evropiane.
Në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më 2023 u kryen bastisje pas publikimit të audio-incizimeve nga portali "Nacionale", ku ishte pretenduar se një sasi vaji, e blerë në Poloni, dhe një sasi gruri, e blerë në Turqi, nuk kishin arritur kurrë.
Atëbotë Hajdari deklaroi se blerjet për rezerva shtetërore ishin bërë në përputhje me ligjin, por nuk dha më shumë hollësi, meqë informacionet për to janë sekrete shtetërore. Ajo e akuzoi policinë se gjatë bastisjeve ka marrë në cilësinë e provave dokumente të klasifikuara si sekrete shtetërore.
Si dëshmitar për këtë rast është thirrur edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, por deri më tani nuk ka pranuar të shkojë në Prokurorinë Speciale, duke ngulur këmbë të japë dëshminë në Kryeministri.
Për rastin e rezervave shtetërore, Kurti i ka dalë në mbrojtje Hajdarit, duke thënë se "nuk ka kurrfarë korrupsioni dhe keqpërdorimi".

## CETIS merr sërish kontratën për fletëvotimet e 28 dhjetorit

Prishtinë, 10 dhjetor - Kompania sllovene CETIS, e cila u kritikua për gabimet teknike në fletëvotimet e balotazhit të 9 nëntorit, është përzgjedhur përsëri nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për t'i shtypur fletëvotimet dhe broshurat e kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit.
Sipas njoftimit të publikuar në platformën "e-prokurimi", vlera e kontratës arrin në 275 742 euro. Pas balotazhit të 9 nëntorit, një komision i posaçëm i KQZ-së kishte verifikuar fletëvotimet e komunave ku u zhvillua procesi.
Ndërsa raporti i kompanisë CETIS kishte evidentuar 1 874 fletëvotime me gabime, të shpërndara në 18 komuna.





# GJYKATA SPECIALE E LIRON ME KUSHT ISNI KILAJN

Të mërkurën e 10 dhjetorit Isni Kilaj është liruar me kusht nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Sipas njoftimit për medie, vendimi për lirimin me kusht është marrë më 3 dhjetor. Gjykatësi ka vlerësuar se rrethanat kanë ndryshuar dukshëm që nga rishikimi i fundit i paraburgimit në tetor, duke konstatuar se vazhdimi i mbajtjes së Kilajt në paraburgim nuk është më i arsyeshëm dhe as proporcional. Në vendimin e Speciales përcaktohet se në qoftë se Kilaj do të shkelë cilindo prej kushteve të lirimit të tij, do të lëshohet një fletarrestim për arrestimin e tij të menjëhershëm

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Hagë, 10 dhjetor - Ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, është liruar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, pasi gjykatësi vendosi se mbajtja e tij në paraburgim nën akuzat për pengim të drejtësisë nuk ishte "as e arsyeshme, as proporcionale".

Gjykata Speciale njoftoi të mërkurën se gjykatësi erdhi në përfundim se e drejta themelore e Kilajt për lirim peshon më shumë sesa rreziku që ai të ketë ndikim në procesin e drejtësisë në gjyqin ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili është buzë përfundimit.

Kilaj, së bashku me ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ish-ministrin e Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ish-shefin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliun - akuzohen për pengim të drejtësisë në rastin kundër Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Gjykimi ndaj tyre do të nisë më 24 shkurt.

Kilaj u arrestua dhjetorin e kaluar dhe prej atëherë është mbajtur në paraburgim në qytetin holandez.

Gjykatësi tha në vendim se rrethanat kanë ndryshuar që prej rishikimit të paraburgimit të Kilajt në tetor dhe se mbajtja e tij në paraburgim nuk ishte më e arsyeshme. "Sot më 10 dhjetor 2025 Isni Kilaj u lirua me kusht në Kosovë, me kushte të vendosura pas rishikimit të fundit të paraburgimit nga gjykatësi i vetëm i ngarkuar me gjykimin e çështjes Prokurorja e Specializuara k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit ("Çështja 12"). Në vendimin e 3 dhjetorit 2025, gjykatësi konstatoi se rrethanat kishin ndryshuar që prej rishikimit të paraburgimit të z. Kilaj në tetor 2025 dhe se mbajtja e tij në paraburgim nuk ishte më as e arsyeshme, as proporcionale. Megjithëse gjykatësi konstatoi se ekzistonte njëfarë rreziku që në qoftë se lirohet, z. Kilaj mund ta pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra penale të tjera, ai arriti në përfundimin se në rrethanat konkrete e drejta themelore e z. Kilaj për liri peshon më shumë se këto rreziqe. Ndër faktorë të tjerë, gjykatësi mori parasysh se koha që z. Kilaj ka kaluar në paraburgim në këtë moment tejkalon dënimin minimal sipas ligjit me të cilin ai do të përballej në qoftë se do të shpallej fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar. Gjykatësi, gjithashtu, mori parasysh se nuk është paraqitur asnjë provë që tregon se z. Kilaj ishte orvatur ta pengonte procesin gjatë periudhës së lirimit të tij të mëparshëm me kushte në vitin 2024; se ka përfunduar paraqitja e provave në çështjen Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe se rreziku që z. Kilaj mund të ndikojë në dëshmitarët e Prokurorisë në Çështjen 12 është shumë i ulët duke marrë parasysh rrethanat e tyre specifike. Gjykatësi, gjithashtu, konstatoi se nuk ka rrezik që z. Kilaj të arratiset bazuar në periudhën e lirimit të tij të mëparshëm dhe shumën e ofruar të konsiderueshme si dorëzani financiare që do të humbiste. Z. Kilaj mbetet i akuzuar në gjykimin aktual dhe për lirimin e tij janë caktuar disa kushte që synojnë ta zvogëlojnë rrezikun e ndikimit të tij ndaj dëshmitarëve në çështjen gjyqësore kundër të tij ose në çështje të tjera gjyqësore në Dhomat e Specializuara. Në vendim përcaktohet se në qoftë se z. Kilaj do të shkelë cilindo prej kushteve të lirimit të tij, do të lëshohet një fletarrestim për arrestimin e tij të menjëhershëm", është thënë në njoftimin e Gjykatës Speciale.

## OVLUÇK-ja i gëzohet lajmit për lirimin me kusht të bashkëluftëtarit Isni Kilaj

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së i është gëzuar lajmit për lirimin me kusht të bashkëluftëtarit Isni Kilaj nga Gjykata Speciale. "OVLUÇK i gëzohet lajmit për lirimin me kusht të bashkëluftëtarit tonë, z. Isni Kilaj, nga Gjykata Speciale. Ky vendim rikthen një të drejtë të tij që i është mohuar padrejtësisht për një kohë të gjatë, njësoj siç po vazhdon të mohohet edhe për bashkëluftëtarët e tjerë që mbahen ende në paraburgim. Për ne, ky zhvillim përbën një hap drejt reflektimit të domosdoshëm nga ana e kësaj gjykate, e cila deri më tani ka refuzuar të respektojë të drejta të garantuara me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e OVLUÇK-së.

# BEDRI HAMZA KËRKON ROL AKTIV TË SHBA-së NË PROCESIN E DIALOGUT

Prishtinë, 10 dhjetor - Kryetari i PDK-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Bedri Hamza, ka kërkuar rol më aktiv të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në procesin e dialogut, 'pa përjashtuar edhe rolin e BE-së'. Ai ka folur edhe për Draftin e Statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në një intervistë për ATV-në.

Bedri Hamza ka theksuar se 'formati i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të ndryshojë', duke kërkuar rol më aktiv të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Kjo nuk është temë e lehtë, por ky format duhet të ndryshojë. Unë besoj se me një punë intensive, korrekte, partneritet dhe besim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës të kenë një rol aktiv në këtë proces, gjithmonë duke e vlerësuar dhe respektuar rolin e BE-së. Mirëpo, për vlerësimin tim, nuk është mjaftueshëm që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të kenë një rol më periferik, port të jenë direkt të involvuara në procesin e dialogut", ka deklaruar Hamza.

Ai ka thënë se Drafti i Asociacionit ka 'disa elemente që duhet të adresohen' si çështja e Rezolutës 1244 dhe Arbitrazhi. "Te drafti aktual, për shkak se ne jemi vonuar, sepse ne nuk e kemi prodhuar draftin dhe na kanë prodhuar të tjerët, ndërkaq tash është shumë më vështirë të bëhen intervenimet në atë draft ku me ardhë në atë formatin ku realisht do të ishte në një masë të caktuar nëse Kosovës i hapet perspektiva për integrim në BE dhe NATO. Aty janë disa çështje që duhet të adresohen. Rezoluta 1244 nuk e ka vendin në dokumentet e brendshme të Republikës së Kosovës. Nuk e ka vendin Arbritrazhi, për shkak se ti zhvleftëson rolin e Gjykatës Kushtetuese", ka thënë Hamza.



Ai ka deklaruar se Kosova duhet të sigurohet që në fillim se cili 'do të jetë përfundimi i procesit të dialogut' me synimin që të bëhemi anëtar i BE-së dhe NATO-së. "Përtej kësaj, Kosova duhet të sigurohet se cila është finalja e këtij procesi, e jo për të mbetur si temë e hapur, kjo çështja e dërgimit të Draftit të Asociacionit si temë e hapur dhe se kur Kosova e ka perspektivën me qenë anëtar i BE-së, me qenë anëtar i NATO-s. Po ndryshojnë rrethanat, jemi vonuar. Për Kosovën është jetike për të pasur elementet e sigurisë, të sovranitetit, tërësisë territoriale", ka thënë Hamza.

Kryetari i PDK-së ka bërë me dije se u ka thënë kryetarëve të partive politike, se 'e vetmja temë ku duhet të bashkohen të gjithë është dialogu'. "Ua kam thënë edhe në takime të përbashkëta me partitë politike, krejt bashkë edhe jemi pak. Ne mund të kemi pasur dallime për çështje politike, ekonomike, por në këtë temë, përveç që duhet të jemi bashkë, duhet të japë rolin e vet edhe shoqëria civile, pra të gjithë aktorët", ka thënë Hamza.

# RIKTHIMI I QYTETARËVE NGA ZONAT E KONFLIKTIT, KOSOVA TREGON PËRVOJËN NË BRUKSEL

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 10 dhjetor** - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka bërë me dije se ka marrë pjesë në takimin e 23-të të Bordit të GCERF-së në Bruksel, ku ka diskutuar për sfidat e sigurisë, të cilat, sipas tij, kërkojnë angazhim të pandërprerë. "Kisha kënaqësinë të marrë pjesë në takimin e 23-të të Bordit të GCERF në Bruksel, ku bashkë me partnerë ndërkombëtarë diskutuam për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe forcimin e sigurisë sonë kolektive. Në këtë forum




prezantova përvojën e Republikës së Kosovës në rikthimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e qytetarëve tanë të kthyer nga zonat e konfliktit, ku vendi ynë ka treguar lidership dhe rezultate të prekshme, me theks të veçantë në mbrojtjen e grave dhe fëmijëve", ka thënë ai.

Sveçla gjatë fjalës së tij vuri në theks edhe një herë se sfidat e sigurisë evoluojnë vazhdimisht dhe kërkojnë angazhim të pandërprerë, bashkëpunim ndërinstitucional dhe partneritete të forta ndërkombëtare. "Për këtë arsye, vlerësoj lart bashkëpunimin me GCERF dhe mbështetjen e të gjithë aleatëve tanë në këtë rrugëtim. Në këtë panel nënvizova se pikërisht vullneti politik ka qenë parakusht i suksesit të Kosovës në riatdhesimin dhe riintegrimin e 123 shtetasve tanë nga veriu i Sirisë. Ky ishte një proces që e kemi udhëhequr me përgjegjësi dhe përkushtim, duke vënë në plan të parë sigurinë dhe të ardhmen e qytetarëve tanë. Po ashtu, sot para medieve të pranishme në konferencën për shtyp organizuar nga GCERF prezantova arritjet e Republikës së Kosovës që kanë reflektuar pozitivisht në çdo raport kredibil ndërkombëtar. Republika e Kosovës do të vazhdojë të jetë e gatshme të kontribuojë në iniciativat globale të sigurisë dhe të mbetet shembull i praktikave të mira në rajon dhe më gjerë. Përkushtimi ynë mbetet i qartë: t'i mbrojmë qytetarët tanë dhe të ndërtojmë një të ardhme më të sigurt për të gjithë", ka thënë Sveçla.

# POLICIA E KOSOVËS DHE AMBASADA AMERIKANE REALIZOJNË USHTRIM NË SHKALLË TË GJERË PËR REAGIM NDAJ KRIZAVE

**Prishtinë, 10 dhjetor** - Përmes këtij njoftimi zyrtar Policia e Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, njofton opinionin publik se të premten, më 12 dhjetor nga ora 15:00-21:00, do të realizojë një ushtrim të gjerë në Prishtinë, përfshirë zonën pranë objektit të Ambasadës Amerikane, e cila gjendet në lagjen Arbëria të Prishtinës.

Ushtrimet e përbashkëta të Policisë së Kosovës dhe Ambasadës Amerikane janë një tregues i forcimit të mëtejmë të bashkëpunimit në siguri dhe për ta siguruar gatishmërinë në menaxhimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente dhe të çfarëdo incidenti të mundshëm në Kosovë.

Përmes këtij ushtrimi synohet testimi i kohës së reagimit, efektiviteti dhe efikasiteti i zyrtarëve dhe pajisjeve, si dhe komunikimi e koordinimi ndërmjet njësive dhe institucioneve relevante në situata emergjente, ku kërkohet garantimi i një ambienti të sigurt për qytetarët, stafin diplomatik dhe institucionet e Kosovës.

Pjesëmarrja në këtë ushtrim do të përfshijë prani të shtuar të Policisë së Kosovës dhe personelit të sigurisë së Ambasadës Amerikane, përdorim të shtuar të mjeteve dhe pajisjeve të ndryshme policore siç janë altoparlantët, sirenat e mjetet të ndryshme logjistike policore. "Pra ky do të jetë vetëm një ushtrim e jo veprim policor ndaj një incidenti të vërtetë, andaj kërkojmë bashkëpunim dhe mirëkuptim të plotë nga qytetarët, në veçanti nga pjesëmarrësit në trafik, që në këtë kohë ta shmangin qarkullimin në zonën përreth Ambasadës Amerikane në



Prishtinë - lagjja Arbëria për shkak të zhvillimit të ushtrimit dhe ndërprerjes së qarkullimit të përkohshëm të disa segmenteve rrugore në atë zonë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

# 50-VJETORI I ASHAK-ut: THEMELIMI I KËTIJ INSTITUCIONI PESË DEKADA MË PARË SHËNOI NJË MOMENT HISTORIK



Akademik Arsim BAJRAMI

Sot Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës shënon 50-vjetorin e themelimit të saj - një përvjetor jubilar i një prej institucioneve më madhore të identitetit tonë shkencor, kulturor dhe kombëtar. Themelimi i këtij institucioni, pesë dekada më parë, përbënte një moment historik të emancipimit të shoqërisë sonë dhe të afirmimit të popullit shqiptar në Kosovë si bartës i vlerave të mirëfillta akademike e civilizuese.

Në rrethanat e asaj kohe, themelimi i Akademisë nuk ishte thjesht një akt institucional, por një deklarim i fuqishëm i vullnetit kolektiv për të kultivuar shkencën, artin dhe mendimin kritik si shtylla të identitetit tonë. Ky moment përfaqësoi hapjen e një etape të re, ku intelektualët, krijuesit dhe dijetarët tanë morën rolin e merituar në ndërtimin e një kulture moderne, në forcimin e vetëdijes sonë historike dhe në promovimin e vlerave universale të dijes.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës është institucioni më i rëndësishëm dhe më i lartë të dijes shkencore dhe të krijimtarisë artistike. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka qenë dhe është simbol i ngritjes së Kosovës në periudhën më të re të historisë së saj, simbol i emancipimit të përgjithshëm, i ngritjes diturore dhe prosperitetit shoqëror, ekonomik dhe kulturor, përfshirë edhe pavarësimin e saj dhe konsolidimin e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) është themeluar më 20 dhjetor të vitit 1975 në Prishtinë me Ligj të veçantë të Kuvendit të Kosovës. Akademia është institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Akademia është institucion i pavarur në fushën e shkencës dhe të artit. Veprimtaria e Akademisë është e interesit të veçantë publik në Republikën e Kosovës. Interesi i veçantë publik i Akademisë shprehet në ushtrimin e veprimtarisë së saj në fushën e shkencës dhe të artit, që përfshin promovimin, kultivimin, nxitjen dhe zhvillimin e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës si institucion i pavarur dhe më i lartë shkencor dhe artistik në Kosovë aspiron përsosmërinë shkencore dhe artistike dhe ndikimin e shkencës, të artit dhe të kulturës në zhvillimin e shoqërisë. AShAK-u si institucion mëton të reflektojë autoritet, besueshmëri dhe pavarësi, duke u mbështetur në një sistem vlerash të ndërtuara mbi rigorozitet shkencor, mendim kritik dhe transparencë. Ajo ndërmerr hapa për rritjen e kontributit të shkencës dhe të artit në krijimin e shoqërisë së bazuar në dije dhe kulturë, si kusht i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Akademia njëherësh synon ndërlidhjen e krijimtarisë shkencore dhe artistike të Kosovës me vendet e tjera në Evropë dhe në botë, duke kultivuar përkujdesje sistematike për trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

AShAK-u punon për nxitjen, zhvillimin, promovimin dhe avancimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, për ndërtimin e një shoqërie të bazuar në dije. Realizon, ideon dhe organizon projekte shkencore dhe artistike me interes për zhvillimin shoqëror, ekonomik e kulturor të Kosovës përmes botimit të materialeve kërkimore nga fusha e shkencës, e artit dhe e kulturës; përmes mbajtjes së aktiviteteve artistike dhe të diskutimeve kulturore, me qëllim të ngritjes së mendimit kritik në Kosovë; promovimit të mendimit shkencor e artistik në Kosovë dhe përfshirjes së këtij mendimi në rrjedhat globale.

Me suprimimin e autonomisë së Kosovës, AShAK iu nënshtrua politikave represive serbe. Në prill të vitit 1989 u ndërpre financimi i veprimtarisë së Akademisë me "arsyetimin" se nuk i përmbush standardet jugosllave dhe se me angazhimet e saj publike e cenonte rendin kushtetues të ish-Jugosllavisë.

Në vitin 1992 Kuvendi i Serbisë, edhe pse nuk ishte themelues i kësaj Akademie, shpalli të mbyllur AShAK-un. Anëtarët e kësaj Akademie nuk e përfillën vendimin e Serbisë dhe vazhduan punën në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme deri në vitin 1994, kur policia serbe mbylli godinën e AShAK-ut duke e përdorur atë për qëllime të tjera. Me nismën dhe frymëzimin e drejtpërdrejtë të SASA-së (Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve) në vitin 1992, përmes ligjit për Akademinë Serbe të sponsorizuar nga ajo vetë, Parlamenti okupues i Serbisë e shpalli të mbyllur Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës të themeluar nga Parlamenti i Kosovës dekada më parë. Më 1994 pushteti okupues serb sekuestroi ndërtesën e Akademisë së Kosovës bashkë me bibliotekën, arkivin dhe gjithçka tjetër, kështu që Akademia qe e shtrënguar të vazhdonte punën e saj në një shtëpi private.

Pas përfundimit të luftës Akademia rikthehet në objektin e saj, kurse nga viti 2009 ajo vendoset në objektin modern të saj të ndërtuar nga Ministria e Administratës Publike. Në vitin 2015 MASHT në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e AShAK, hartoj Ligjin për AShAK-un i cili u miratua në Kuvendin e Kosovës.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës për më shumë se pesë dekada të ekzistimit të saj nuk ka qëndruar indiferente ndaj zhvillimeve të mëdha shoqërore dhe politike. Akademia e ka shprehur publikisht mendimin shkencor për shumë çështje në çastet kyçe të zhvillimeve shoqërore dhe politike: nga Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990 dhe gjatë gjithë viteve 90, pas luftës është shprehur disa herë për statusin e Kosovës, për bisedat e Vjenës 2005-2007, për Mitrovicën dhe veriun e vendit, për Kushtetutën, për Planin e Ahtisarit, për decentralizimin, për Luginën e Preshevës, për trashëgiminë kulturore, për regjistrimin e popullsisë, për procesin e anëtarësimit në UNESCO, për sjelljen e SANU-së ndaj Kosovës dhe shqiptarëve etj. Për të gjitha këto çështje Akademia ka shprehur qëndrime publike, ka mbajtur disa tryeza dhe konferenca shkencore, ka botuar studime, monografi dhe libra. Në mënyrë të veçantë, viteve të fundit Akademia ka bërë studime dhe konferenca shkencore, ku është argumentuar me fakte shkencore gjenocidi i Serbisë në Kosovë.

Me këtë rast të shënuar, në këtë jubile të madh që kurorëzon gjysmë shekulli ekzistence, pune dhe përkushtimi, ne shprehim me përulësi të thellë falënderimin dhe mirënjohjen tonë post mortem për të gjithë akademikët themelues. Ata, me vizionin e tyre largpamës, me guximin intelektual dhe me sakrificën e heshtur, ngritën themelet e këtij tempulli të dijes dhe shkencës në Republikën e Kosovës. Nëpërmjet veprës së tyre, ata vunë gurët e parë të një institucioni që sot përfaqëson jo vetëm memorien e përbashkët shkencore të vendit, por edhe aspiratën tonë kolektive për përparim, emancipim dhe zhvillim. Në nder të tyre, ne riafirmojmë zotimin tonë për ta çuar përpara misionin e Akademisë, me përgjegjësi të pashuar dhe përkushtim ndaj idealeve që ata përfaqësuan.

Republika e Kosovës, përmes Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ka krijuar kushte të mirëfillta për punën dhe pavarësinë institucionale të këtij tempulli të dijes. Ky kuadër ligjor ka garantuar autonominë funksionale të Akademisë, duke i mundësuar asaj të zhvillojë misionin e vet shkencor dhe artistik në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të pakompromis.

Për më tepër, shteti ka siguruar kushte të përparuara hapësinore dhe një pozitë të qëndrueshme materiale, e cila sot vlerësohet ndër më të mirat në rajon. Kjo përkujdesje institucionale jo vetëm që reflekton respektin e Republikës së Kosovës ndaj dijes dhe shkencës, por edhe afirmon bindjen se Akademia duhet të mbetet një bastion i mendimit të lirë, i profesionalizmit dhe i integritetit akademik.

Në këtë kontekst, duke shënuar me krenari këtë jubile epokal të gjysmë shekullit të punës dhe veprimtarisë, para Akademisë sonë shtrohet sot sfida e reformimit të saj, në mënyrë që ajo të përmbushë plotësisht funksionin dhe misionin e vet si avangardë e mendimit dhe krijimtarisë shkencore në Kosovë.

Me këtë rast do të gjithë akademikëve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës i urojmë 50 vjetorin e themelimit!

## Patentohet ventilatori mekanik, shpikja e vitit 2024 e profesorit të UP-së

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Profesorit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës, prof. Arbnor Pajazitit, i është miratuar dhe njohur patenta e "Ventilatorit mekanik me lidhje riveprues të rregullimit" nga Agjencia për Pronësi Industriale e Republikës së Kosovës.
Profesorit Pajaziti për shpikjen e patentuar i kishte ndihmuar shumë edhe i diplomuari i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në nivelin master dhe inxhinieri, Petrit Abdyli.
Aplikimi për patentë ishte bërë në shkurt të vitit 2024, ndërsa patenta vlen deri më 2 shkurt 2044. Ventilatori mekanik është një pajisje inovative që mund të përdoret në fusha ku kërkohet kontroll i avancuar i procesit të ventilimit.
Ai bën lidhjen mes fushës së mekatronikës, mjekësisë e industrisë dhe tregon se Universiteti i Prishtinës dhe njësitë akademike të tij janë në hap me zhvillimet teknologjike të kohës dhe inovacionin.
Ideja e ndërtimit të ventilatorit mekanik që u financua nga BE-ja dhe Rektorati i Universitetit të Prishtinës kishte lindur në kohën e përballjes globale me virusin Covid 2019, kur mësimi zhvillohej online dhe kishte nevojë të madhe për pajisje të tilla.




## AUDITIMI KA IDENTIFIKUAR MANGËSI NË PROCESIN E NDËRTIMIT TË OBJEKTIT PËR KLINIKAT NEFROLOGJI DHE HEMATO-ONKOLOGJI NË SHSKUK



PRISHTINË, 10 DHJETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të pajtueshmërisë "Ndërtimi i objektit për Klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji" në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për periudhën 2018 - qershor 2025.
Auditimi ka vlerësuar pajtueshmërinë e procesit të ndërtimit të objektit me rregullat dhe kërkesat ligjore që nga procesi i buxhetimit dhe planifikimit, procedurat e tenderimit deri te menaxhimi i fondeve dhe implementimi i kontratës. Procesi i auditimit ka identifikuar mangësi në procesin e buxhetimit, tenderimit dhe menaxhimit të fondeve.
Auditimi vë në pah mospërputhje në planifikimin buxhetor për ndërtimin e objektit për klinikat Hemato-Onkologji dhe Nefrologji, qasje të dyfishtë në hartimin e specifikave teknike, mospërputhje në mes të dokumentacionit teknik të projektit dhe paramasës, si dhe mangësi në procesin e vlerësimit të ofertës gjatë procesit të tenderimit dhe në procesin e menaxhimit të shpenzimeve.
Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka theksuar se mangësitë e evidentuara nga auditimi reflektojnë nevojën për qasje më sistematike dhe respektim të plotë të kornizës ligjore në zbatimin e projekteve. Kjo do ta mundësojë rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit në menaxhimin e fondeve publike.
Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka dhënë pesë rekomandime për të përmirësuar dhe siguruar mbarëvajtjen e proceseve nga faza e planifikimit e deri te zbatimi i tyre.

## PRINDON SADRIU FTOHET NË SHTËPINË E BARDHË NË SAMITIN E ORGANIZUAR NGA ZONJA E PARË, MELANIA TRUMP



PRISHTINË, 10 DHJETOR - Zotëria i Parë i Republikës së Kosovës, Prindon Sadriu, ka pranuar ftesë zyrtare nga Zonja e Parë e ShBA-së, Melania Trump, për të marrë pjesë në samitin ndërkombëtar që do të mbahet në Shtëpinë e Bardhë në muajin mars. Samiti do t'i dedikohet iniciativës së Zonjës së Parë Melania Trup "Fostering the Future Together", së cilës Kosova iu bashkua në shtator 2025.
Kjo nismë globale e Shtëpisë së Bardhë do të vërë në dispozicion teknologji të avancuara, përfshirë inteligjencën artificiale, për t'i mbështetur fëmijët, prindërit si dhe edukatorët, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e të rinjve nga rreziqet online.
Kompanitë më të mëdha botërore të teknologjisë janë zotuar t'i ofrojnë këto mjete pa kosto ose me kosto shumë të ulët për Kosovën dhe vendet e tjera pjesëmarrëse.
Iniciativa e zonjës së parë Trump lidhet edhe me prioritetet e presidentes Osmani për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga rreziqet digjitale si dhe zhvillimin e sektorit të teknologjisë informative në përputhje me interesat e fëmijëve.
Presidenca e Kosovës do të kontribuojë me angazhim konkret në mbështetjen e kësaj iniciative nëpërmjet planeve që tashmë i janë paraqitur administratës së presidentit Trump.
Pjesëmarrja e Kosovës në këtë samit nënvizon angazhimin tonë në fuqizimin e aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për ta avancuar mirëqenien dhe zhvillimin e gjeneratës së re, si dhe për të forcuar më tej partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

## FSK-ja realizon kursin "Medik Luftarak"

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Në Qendrën e Trajnimeve të Regjimentit të Mjekësisë të Komandës së Logjistikës u realizua kursi "Medik Luftarak/Cobat Medik" për pjesëtarët e Regjimentit të Parë të Komandës së Forcave Tokësore.
Realizimi i këtij kursi u bë në bazë të standardeve të NATO-s, me qëllim të përgatitjes së personelit ushtarak me njohuri dhe shkathtësi bazike dhe të avancuara mjekësore për të ofruar kujdes urgjent dhe efektiv në fushëbetejë.
Në ceremoninë e certifikimit të pranishëm ishin edhe zëvendëskomandanti i logjistikës, kolonel Mehmet Lladrovci, komandanti i regjimentit të mjekësisë, dr. kolonel Xhevdet Tahiraj si dhe komandanti i regjimentit të parë të KFT-së, nënkolonel Arben Abdyli.
Në fjalën e tij kolonel Lladrovci theksoi se trajnime të tilla synojnë ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve operacionale, avancimin drejt anëtarësimit në NATO dhe forcimin e gatishmërisë për mbështetjen e operacioneve të paqes kudo që kërkohet.
Ky trajnim synon rritjen e mbijetesës së të plagosurve përmes menaxhimit të traumave, kontrollit të gjakderdhjes, ruajtjes së rrugëve të frymëmarrjes, stabilizimit të gjendjes së pacientit dhe përgatitjes për evakuim mjekësor, duke siguruar ndërhyrje të koordinuar dhe të standardizuar sipas protokolleve taktike të kujdesit para-spitalor.



# FESTAT E SHTRENJTA: ÇMIMET RRISIN BARRËN PËR FAMILJET E KOSOVËS

Familjet në Kosovë po përballen me vështirësi financiare gjatë festave të fundvitit për shkak të rritjes së çmimeve të produkteve bazë dhe ushqimore. Ekspertët paralajmërojnë se tregtarët shfrytëzojnë periudhat festive për t'i ngritur çmimet, ndërsa institucionet shtetërore kanë kontroll të kufizuar mbi tregun. Remitencat e diasporës mbeten faktorë kyçë për mbajtjen e konsumit dhe stabilitetit financiar të familjeve




**Prishtinë, 10 dhjetor** - Në Kosovë festat e fundvitit nuk janë thjesht kohë gëzimi. Për shumë familje ato janë një provë reale financiare.

Çmimet e larta të produkteve bazë, ushqimore dhe të energjisë, e bëjnë të vështirë përballimin e shpenzimeve festive për familjet me të ardhura mesatare dhe të ulëta.

Besim Krasniqi, punonjës në sektorin privat me një pagë prej 550 eurosh në muaj, duhet ta kursejë gati gjysmën e të ardhurave mujore vetëm për t'i përballuar shpenzimet e natës së Vitit të Ri. "Çdo ditë dal në dyqane dhe i hulumtoj çmimet. Një kilogram mish i terur është 26.00 euro, ndërsa mishi i kuq i viçit ka arritur në 16.00 euro. Kjo është jashtë normales", thotë ky banor i Prishtinës për Radion Evropa e Lirë.

Familja e tij gjashtanëtarëshe mbështetet vetëm te paga e tij, dhe vitin e kaluar shpenzoi rreth 200 euro për festat. Sivjet parashikon të shpenzojë të paktën 270 euro për shkak të rritjes së çmimeve. "I kam katër fëmijë dhe ata kanë kërkesa - dekorime, ëmbëlsira, pije, mish e gjëra të tjera", thotë Krasniqi.

Ekspertët e ekonomisë paralajmërojnë se kjo rritje e çmimeve nuk është e rastësishme.

Ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ismet Mulaj, thotë se tregtarët shpesh shfrytëzojnë periudhat festive për t'i ngritur çmimet. Kjo situatë, sipas tij, ushtron presion të madh mbi familjet me të ardhura të kufizuara, veçanërisht kur më shumë se gjysma e pagës mujore shkon për konsum.

Statistikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se trendi i rritjes së çmimeve ka nisur që muaj më parë. Sipas të dhënave të fundit, në tetor të këtij viti, çmimet e konsumit janë rritur për 5.1 % krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.

Rritjet më të mëdha janë regjistruar tek energjia elektrike (+20 %), pemët (+15.3 %), kafeja e çaji (+13 %), mishi (+12.3 %), qumështi, djathi dhe vezët (+7.5 %).

Paga mesatare bruto në Kosovë është 639 euro, ndërsa të dhënat e ASK-së tregojnë se mbi 55 % të kësaj page qytetarët e shpenzojnë vetëm për konsum.

Ky raport i lartë mes të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas ekspertit Mulaj, dëshmon qartë sfidat e vazhdueshme me të cilat përballen konsumatorët për ta mbajtur nën kontroll koston e jetesës. Ai thekson se disa nga produktet kryesore në tregun e Kosovës, si mielli, kushtojnë më shumë sesa në tregun e Bashkimit Evropian - gjë që bëhet edhe më problematike kur merret parasysh niveli më i ulët i pagave dhe standardi i jetesës.

"Kjo shprehi e rritjes së çmimeve lë hapësirë për dyshime mbi marrëveshje të mundshme apo keqpërdorim të pozitës dominuese nga disa kompani", thotë Mulaj për Radion Evropa e Lirë.

Një problem tjetër kritik mbetet mungesa e kontrollit institucional. "Tregtarët, në një mënyrë, janë bërë aq të fuqishëm, saqë edhe institucionet ekzekutive dhe ato të pavarura e kanë të vështirë të hyjnë në një ballafaqim profesional dhe të drejtpërdrejtë me ta, sepse për 20 vjet janë konsoliduar dhe kanë arritur të krijojnë pozita të forta në tregun e Kosovës", thotë Mulaj.

Përshtypje të ngjashme ka krijuar edhe Krasniqi, i cili thotë se blen vetëm artikuj në zbritje. "Tregtarët nuk frikësohen. Nuk ka as kontroll të çmimeve, as inspektime", sipas tij.

Çmimet e produkteve i përcaktojnë vetë tregtarët në bazë të konkurrencës dhe raportit ofertë-kërkesë.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe Inspektorati i Tregut monitorojnë tregun. Në një përgjigje me shkrim për Radion Evropa e Lirë, Autoriteti tha se ka pranuar disa ankesa nga qytetarët për rritjen e çmimeve të disa produkteve bazike, sidomos vezëve dhe se, aktualisht, janë duke u zhvilluar inspektime dhe aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me to. "Nëse gjatë këtij procesi dalin të dhëna që sugjerojnë sjellje të mundshme antikonkurruese, Autoriteti do të ndërmarrë masa sipas mandatit ligjor, përfshirë hapjen e hetimeve të thelluara", thuhet në përgjigje, por pa ndonjë specifikim më shumë.

Inspektorati i Tregut, ndërkaq, nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për të sqaruar nëse qytetarët kanë paraqitur ankesa për ngritjen e çmimeve, apo nëse parashihen kontrolle shtesë gjatë këtij muaji, kur vendi hyn në periudhën e festave të fundvitit, në të cilën çmimet tradicionalisht rriten.

Në këtë situatë, remitencat e diasporës bëhen një mbështetje jetike. "Pa diasporën", thotë Mulaj, "Kosova do të kishte probleme të jashtëzakonshme ekonomike".

Këto dërgesa, ashtu si dhe vizitat e mërgimtarëve gjatë sezonit të pushimeve, përmirësojnë dukshëm standardin e jetesës dhe mbajnë gjallë konsumimin, sipas tij.

Vlera e remitencave deri më tash këtë vit ka kaluar një miliard euro.

Në mungesë të këtij "furnizimi të jashtëm financiar", konsumi i ekonomive familjare do të binte ndjeshëm dhe, rrjedhimisht, qytetarët do të përballeshin me varfëri të thellë dhe mungesë të produkteve bazë, vlerëson Mulaj.

Mulaj thekson se një pjesë e çmimeve varet edhe nga tregu i jashtëm, pasi Kosova importon shumicën e mallrave. Sipas tij, institucionet nuk kanë krijuar një ambient mbështetës për prodhuesit vendorë që ta rrisin prodhimin dhe të ofrojnë çmime më të ulëta. Pa këtë politikë tregu mbetet i varur nga importi dhe çmimet mbeten të larta. Në një adresim nga foltorja e Kuvendit, muajin e kaluar kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se "në Kosovë nuk ka krizë ekonomike", prandaj "edhe nuk ka protesta të qytetarëve". Por, realiteti i përditshëm i familjeve si ai i Krasniqit tregon të kundërtën - një periudhë festive e shoqëruar me vështirësi të ndjeshme financiare. "Asnjëherë nuk shkoj në dyqan që të furnizohem për një ose dy javë, zakonisht i përcjell zbritjet javore ose ditore", përfundon ai.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Sigal Prishtina shënon fitore të thellë kundër Opavas



**Prishtinë, -** Sigal Prishtina i është rikthyer triumfit në Ligën ENBL, duke i shkaktuar humbjen e parë ekipit çek, BC Opava. "Bardhekaltrit" kanë fituar bindshëm 102:75 në ndeshjen e zhvilluar të martën mbrëma në Pallatin e Rinisë. Pas dy humbjeve radhazi në këtë garë ndërkombëtare dhe tri në kampionatin vendor, kryeqytetasit kanë reaguar, duke u treguar më të mirë nga periudha e dytë e deri në fund të takimit. Me këtë fitore, Prishtina regjistron fitoren e katërt në ENBL, ndërsa Opava tani ka bilanc prej katër fitoreve dhe një humbje. Pesë lojtarë të Prishtinës kanë shënuar pikë dyshifrore. Më i dalluari ishte Deondre Burns me njëzet e shtatë pikë, shtatë asistime dhe gjashtë kërcime. Adrio Bailey ka kontribuar me njëzet e një pikë dhe nëntë kërcime, Tilemachos Vissariou ka shënuar njëzet pikë, ndërsa Arian Azemi i ka shtuar nëntëmbëdhjetë pikë, gjashtë asistime dhe tri kërcime. Ndeshja është zhvilluar në praninë e pak shikuesve. Në ENBL garon edhe Peja.

# DUELE TË FORTA NË 1/8 E KUPËS SË KOSOVËS




**Prishtinë, 10 dhjetor -** Të mërkurën në zyrat e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) është bërë tërheqja e shortit për 1/8 e finales të Kupës së Kosovës. 16 skuadra të Superligës dhe Ligës së Parë synojnë të kualifikohen në mesin e tetë më të mirave për raundin tjetër të kësaj gare, që ndryshe njihet si çerekfinale. Shorti nuk është treguar i mëshirshëm pothuajse për asnjërën prej skuadrave që janë pjesë e 1/8 së finales, pasi ka nxjerrë duele të forta dhe interesante.

Prej përballjeve të Superligës veçohen ndeshjet Prishtina - Ballkani dhe Llapi - Drita, skuadra këto që synojnë ta fitojnë këtë trofe.

Duelet e tjera të skuadrave të Superligës janë edhe Drenica - Ferizaj dhe Dukagjini - Prishtina e Re, ndërsa çiftet e tjera të kësaj faze janë: Gjilani - Liria, Feronikeli '74 - Dinamo, Vushtrria - Vëllaznimi dhe Trepça '89 - Malisheva. Këto ndeshje do të luhen vitin e ardhshëm, saktësisht në fillim të muajit shkurt.

# DRENICA ZYRTARIZON TRAJNERIN THOMAS BRDARIQ

**Skenderaj, 10 dhjetor -** Trajneri i mirënjohur, Thomas Brdariq, ka marrë drejtimin e Drenicës. Skuadra e Superligës së Kosovës ka zyrtarizuar Brdariqin, i cili në këtë post zëvendëson Bylbyl Sokolin e larguar. "FC Drenica shkruan një faqe të re në historinë e futbollit tonë. Me krenari ju njoftojmë se kemi nënshkruar kontratë afatgjate me trajnerin ndërkombëtar Thomas Brdariq, një emër i madh i futbollit gjerman, ish-lojtar i Bundesligës dhe trajner i suksesshëm në disa vende, përfshirë edhe Shqipërinë, ku ai ka arritur rezultate të jashtëzakonshme", ka njoftuar Drenica. Sipas këtij njoftimi, Drenica ka hedhur një hap të guximshëm drejt futbollit modern. "Me përvojën e tij dhe me vizionin tonë të ri, FC Drenica sot hedh një hap të guximshëm drejt futbollit modern evropian. Me ardhjen e tij ne e kemi afruar edhe më shumë Gjermaninë në Drenicë - një standard i ri profesional, një mentalitet i ri fitues dhe një energji e re për të ardhmen e klubit", ka njoftuar Drenica.




Pritjet nga Drenica janë të mëdha me Brdariqin, i cili ka punuar trajner te Shkëndija e Tetovës dhe Vllaznia e Shkodrës. "Drenica ka dhënë shumë për Kosovën, për Shqipërinë dhe për gjithë kombin. Drenica ka qenë gjithmonë zemra e qëndresës, e krenarisë dhe e sakrificës. Drenica ka kontribuar, ka dhënë, ka mbrojtur e ka qëndruar gjithmonë për vendin, për Kosovën dhe për të gjithë shqiptarinë. Prandaj, Drenica e meriton kujdesin, përkrahjen dhe përkushtimin maksimal - nga investitorët e rinj, nga institucionet shtetërore dhe nga të gjithë ne si komb. FC Drenica nuk është vetëm një klub futbolli. Ne nuk duam thjesht një ekip që fiton ndeshje. Ne duam të ndërtojmë një akademi moderne, të bëhemi qendër zhvillimi sportiv për gjeneratat, të krijojmë një model shembullor për gjithë rajonin", ka njoftuar Drenica.

Kujtojmë se Drenica drejtohet nga gjermani Thomas Wüstefeld i cili është president i klubit dhe nënpresidenti Faton Seferi.

# GIANNI INFANTINO AKUZOHET PËR SHKELJE TË KODIT TË FIFA-s, KA TË BËJË ME TRUMPIN

**Paris, 10 dhjetor -** Është paraqitur një ankesë zyrtare ndaj Gianni Infantinos në Komitetin e Etikës së FIFA-s pas dhënies së një çmimi për paqe presidentit të ShBA-së, Donald Trump, gjatë shortit të Kupës së Botës 2026.

FIFA ka tërhequr kritika të mëdha gjatë dhe pas shortit të Kupës së Botës të premten në Kennedy Center në Uashington DC.

Trumpi, i cili është betuar si presidenti i 47 i Shteteve të Bashkuara në janar, është shpërblyer me trofeun inauguruese "Çmimi për Paqe i FIFA-s", duke u njohur për veprimet e tij për ta "promovuar paqen dhe unitetin në mbarë botën".

Sipas faqes zyrtare të FIFA-s, Trumpi ka luajtur "rol kyç në vendosjen e armëpushimit dhe promovimin e paqes në mes të Izraelit dhe Palestinës" dhe ka "përpjekur aktivisht për të ndalur



konflikte të tjera" në mbarë botën. Infantino ia ka dorëzuar Trumpit një trofe të madh të artë, i formuar nga duar që mbajnë tokën dhe një medalje të artë. Ankesa zyrtare është dorëzuar pranë Komitetit të Etikës së FIFA-s. Organizata jofitimprurëse dhe grupi i avokimit "FairSquare" kanë dorëzuar ankesën, e cila pretendon se presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka "shkelur katër herë qartë detyrën e neutralitetit të FIFA-s", të gjitha në lidhje me mbështetjen publike të Trumpit nga presidenti i FIFA-s.

Përveç kësaj, "FairSquare" ka kërkuar që komiteti i etikës t'i "hetojë rrethanat që lidhen me vendimin për të krijuar dhe dhënë Çmimin për Paqe të FIFA-s dhe përputhshmërinë e tyre me rregullat procedurale të FIFA-s". Sipas ankesës, Infantino ka "shkelur katër herë qartë" detyrën e tij për neutralitet, me shkeljen e parë që lidhet me lobimin publik për Donald Trumpin që ta fitonte Çmimin Nobel për Paqe në vitin 2025.

## Sergio Ramos drejt Manchester Unitedit



**Londër, 10 dhjetor -** Sergio Ramos nuk do ta vazhdojë kontratën me Rayados de Monterrey dhe pritet të kthehet në Evropë gjatë merkatos së dimrit. Megjithëse edhe pse ka pasur interesim nga Boca Juniorsi, mbajtja pranë familjes dhe dëshira për të luajtur në nivel të lartë e bëjnë Manchester Unitedin destinacionin e mundshëm për të. Sipas medieve angleze, Unitedi i ka ofruar një kontratë afatshkurtër me role kyçe dhe pagesë të kënaqshme, duke e parë Ramosin si një udhëheqës të nevojshëm për mbrojtjen.

BQK
BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Administrator/e i/e Sistemeve (zyrtar i lartë)
**Grada:** P05
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar
**Departamenti:** Teknologjia e Informacionit dhe Sigurisë
**Divizioni:** I Infrastrukturës dhe Operacioneve
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit të Infrastrukturës dhe Operacioneve

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Konfiguron, monitoron dhe mirëmban pajisjet në infrastrukturën e TI-së, përfshirë serverë, storage, switch dhe pajisje tjera përcjellëse.
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban sistemet operative në serverë fizik dhe virtual.
- Administron dhe mirëmban sisteme me role të ndryshme si: Active Directory, Failover Clustering, File Server, etj.
- Administron mjedisin Microsoft 365 (Exchange Online, Teams, SharePoint Online, OneDrive, Intune).
- Menaxhon identitetet, përdoruesit dhe grupet përmes Microsoft Entra (Azure Active Directory).
- Zbaton politika sigurie si MFA, Conditional Access, Data Loss Prevention dhe masa tjera mbrojtëse.
- Administron infrastrukturën PKI
- Konfiguron dhe mirëmban replikimet e të dhënave dhe sistemeve ndërmjet dy qendrave.
- Menaxhon backup-et e të dhënave dhe rikuperimin në rast emergjence.
- Shërben si nivel i dytë për trajtimin e incidenteve dhe problemeve teknologjike.
- Menaxhon instalimet, azhurnimet dhe ndryshimet në infrastrukturën ekzistuese.
- Konfiguron, instalon dhe përditëson softuerët në serverë dhe kompjuterë të përdoruesve.
- Bashkëpunon me administratorët dhe teknikët e tjerë të TI-së, si dhe me Divizionin e Sigurisë së Informacionit.
- Identifikon dhe trajton dobësitë në infrastrukturë dhe analizon log-ët e sigurisë.
- Monitoron dhe mirëmban sistemin e printimit.
- Merr pjesë aktive në planifikimet afatshkurtra dhe afatgjata të TI-së.
- Përgatit dokumentim, procedura dhe manuale për konfigurimet dhe shërbimet e menaxhuara.
- Kryen detyra tjera sipas kërkesës së eprorëve në Departamentin e TI-së.

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar**

- Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës ose një nga certifikimet e mëposhtme:
  - Microsoft Certified Solutions Expert (MCSE);
  - Microsoft Certified Solutions Associate (MCSA);
  - Microsoft 365 Certification.
- Të paktën 3 vite përvojë në administrimin e sistemeve Windows Server (2019, 2022, 2025).
- Njohuri në Azure dhe Microsoft 365 – e preferuar.
- Certifikim ose përvojë me ITIL – e preferuar.
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **26 dhjetor 2025.**
- Aplikimi mund të bëhet online (**https://hris.bqk-kos.org**) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.

BQK
BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Pozicija:** Administrator/ka sistema (Viši službenik)
**Stepen:** P05
**Trajanje zaposlenja:** na neodređeno vreme
**Odeljenje:** Informacione tehnologije i bezbednosti
**Odsek:** Infrastrukture i operacija
**Izveštava:** Rukovodiocu Odseka za infrastrukture i operacije

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Konfiguriše, prati i održava opremu u infrastrukturi IT-a, uključujući servere, storage, switch i drugu prateću opremu.
- Konfiguriše, instalira, prati i održava operativne sisteme na fizičkim i virtuelnim serverima.
- Administrira i održava sisteme sa različitim ulogama kao što su: Active Directory, Failover Clustering, File Server itd.
- Administrira okruženje Microsoft 365 (Exchange Online, Teams, SharePoint Online, OneDrive, Intune).
- Upravlja identitetima, korisnicima i grupama putem Microsoft Entra-e (Azure Active Directory).
- Sprovodi bezbednosne politike kao što su MFA, Conditional Access, Data Loss Prevention i druge zaštitne mere.
- Administrira infrastrukturu PKI
- Konfiguriše i održava replikaciju podataka i sistema između dva centra.
- Upravlja backup-om podataka i oporavkom u hitnim slučajevima.
- Služi kao drugi nivo za rešavanje incidenata i tehnoloških problema.
- Upravlja instalacijama, ažuriranjima i promenama u postojećoj infrastrukturi.
- Konfiguriše, instalira i ažurira softver na serverima i računarima korisnika.
- Sarađuje sa drugim administratorima i tehničarima IT-a, kao i sa Odsekom za bezbednost informacija.
- Identifikuje i rešava ranjivosti u infrastrukturi i analizira bezbednosne logove.
- Prati i održava sistem za štampanje.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnom i dugoročnom planiranju IT-a.
- Priprema dokumentovanje, procedure i priručnike za upravljane konfiguracije i usluge.
- Obavlja i druge poslove na zahtev pretpostavljenih u IT odeljenju.

**Kvalifikacije i potrebno iskustvo:**

- Univerzitetska diploma iz računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili jedan od sledećih sertifikata:
  - Microsoft Certified Solutions Expert (MCSE);
  - Microsoft Certified Solutions Associate (MCSA);
  - Microsoft 365 Certification.
- Najmanje 3 godine iskustva u administraciji sistema Windows Server (2019, 2022, 2025).
- Poznavanje Azure-a i Microsoft 365 – poželjno.
- Sertifikacija ili iskustvo sa ITIL – poželjno.
- Poznavanje engleskog jezika se smatra prednošću.

**Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:**

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Motivaciono (propratno) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka)
- **Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PAK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, pri čemu diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi kao dokaz o državljanstvu Kosova;

**Procedura e aplikimit:**

- Zadnji rok za apliciranje je **26 decembar 2025. godine.**
- Apliciranje se može obaviti onlajn (**https://hris.bqk-kos.org**) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi oblici apliciranja neće biti uzeti u obzir.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Analist/e i/e sigurisë kibernetike (Zyrtar i lartë)
**Grada:** P05
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar
**Departamenti:** Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë
**Divizioni:** Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit të Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
- Konfiguron sistemet dhe veglat e sigurisë së informacionit, i mirëmban dhe sigurohet që të funksionojnë sipas kërkesave, duke përfshirë sistemet për mbledhje të log-ëve, skanime të sigurisë për dobësi dhe sistemet e tjera të sigurisë se informacionit.
- Monitoron rrjetin kompjuterik për çështjet e sigurisë.
- Monitoron, analizon dhe raporton alarmet e sigurisë, incidentet, raportet mbi dobësitë që mblidhen nga disa burime, si: SIEM, sisteme të tjera të monitorimit, skanime të dobësive, etj.
- Rishikon, hulumton dhe raporton alarmet e dobësive, duke ofruar:
  - ➢ analizën relevante të tyre,
  - ➢ propozon përmirësimet e nevojshme dhe përcjellë përmirësimet e propozuara,
  - ➢ menaxhon skanimet e planifikuara, identifikon zbrazëtitë në to dhe zgjeron fushën e skanimeve sipas nevojës, si dhe përshkallëzon alarmet e sigurisë sipas nevojës.
- Hulumton shkeljet e sigurisë dhe incidentet tjera të sigurisë kibernetike.
- Dokumenton shkeljet e sigurisë dhe vlerëson dëmin që ato shkaktojnë.
- Punon me ekipin e sigurisë për të kryer teste dhe për të zbuluar dobësitë e rrjetit.
- Rregullon dobësitë e zbuluara për të ruajtur një standard të lartë të sigurisë.
- Zhvillon praktikat më të mira në BQK për sigurinë e informacionit.
- Ndihmon në përgatitjen dhe implementimin e programit të vetëdijesimit të shfrytëzuesve të BQK-së për praktikat më të mira të sigurisë së informacionit.
- Mbështet iniciativat e propozuara të sigurisë së informacionit që të sigurojë suksesin e tyre.
- Hulumton për përmirësime të sigurisë dhe bën rekomandime për menaxhmentin.
- Qëndron i azhurnuar në lidhje me avancimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe standardet e sigurisë.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**
- Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës ose një nga certifikimet e mëposhtme:
  - Certified Ethical Hacker (CEH);
  - Cisco Certified Network Associate Security (CCNA Security);
  - Microsoft Technology Associate: Security Fundamentals (MTA Security);
  - CompTIA Security+ ;
  - CompTIA CySA+,
  - certifikime tjera relevente ndërkombëtare të fushës së sigurisë së informacionit.
- Së paku tre (3) vite përvoje në fushën e sigurisë së informacionit.
- Gjuha angleze - e preferuar

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**
- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

**Procedura e aplikimit:**
- Afati i fundit për aplikim është **26 dhjetor 2025.**
- Aplikimi mund të bëhet online (**https://hris.bqk-kos.org**) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Pozicija:** Analitičar za sajber bezbednost (Viši službenik)
**Stepen:** P05
**Trajanje zaposlenja:** na neodređeno vreme
**Odeljenje:** Informacione tehnologije i bezbednosti
**Odsek:** Sajber bezbednosti i kontinuiteta
**Izveštava:** Rukovodiocu odseka za sajber bezbednost i kontinuitet

**Dužnosti i odgovornosti:**
- Konfiguriše sisteme i alate za bezbednost informacija, održava ih i osigurava da funkcionišu u skladu sa zahtevima, uključujući sisteme za prikupljanje logova, skeniranje bezbednosnih ranjivosti i druge sisteme za bezbednost informacija.
- Prati računarsku mrežu u vezi sa bezbednosnim problemima.
- Prati, analizira i izveštava o bezbednosnim upozorenjima, incidentima, izveštajima o ranjivostima prikupljenim iz više izvora, kao što su: SIEM, drugi sistemi za praćenje, skeniranje ranjivosti itd.
- Pregledava, istražuje i izveštava o upozorenjima o ranjivostima, pružajući sledeće:
  - ➢ analizu njihove relevantnosti,
  - ➢ predlaže neophodna poboljšanja i prati predložena poboljšanja,
  - ➢ upravlja planiranim skeniranjem, identifikuje praznine u njima i proširuje obim skeniranja po potrebi, kao i adresira bezbednosna upozorenja po potrebi.
- Istražuje bezbednosna kršenja i druge incidente u vezi sa sajber bezbednošću.
- Dokumentuje kršenja bezbednosti i procenjuje štetu koju one uzrokuju.
- Sarađuje sa bezbednosnim timom kako bi sproveo testove i otkrio ranjivosti mreže.
- Reguliše otkrivene ranjivosti kako bi se održao visok standard bezbednosti.
- Razvija najbolje prakse u CBK-u za bezbednost informacija.
- Pomaže u pripremi i sprovođenju programa podizanja svesti korisnika CBK-a o najboljim praksama bezbednosti informacija.
- Podržava predložene inicijative za bezbednost informacija kako bi se osigurao njihov uspeh.
- Istražuje poboljšanja bezbednosti i daje preporuke menadžmentu.
- Ostaje ažuriran u vezi sa najnovijim vestima u oblasti informacionih tehnologija i bezbednosnih standarda.
- Obavlja i druge poslove po zahtevu rukovodioca.

**Kvalifikacije i potrebno iskustvo:**
- Univerzitetska diploma iz računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili jedan od sledećih sertifikata:
  - Certified Ethical Hacker (CEH);
  - Cisco Certified Network Associate Security (CCNA Security);
  - Microsoft Technology Associate: Security Fundamentals (MTA Security);
  - CompTIA Security+ ;
  - CompTIA CySA+,
  - druge relevantne međunarodne sertifikacije u oblasti informacione bezbednosti.
- Najmanje tri (3) godine iskustva u oblasti informacione bezbednosti.
- Poznavanje engleskog jezika – poželjno

**Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:**
- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Motivaciono (propratno) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka);
- **Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PAK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, pri čemu diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi kao dokaz o državljanstvu Kosova;

**Procedura apliciranja:**
- Zadnji rok za apliciranje je **26 decembar 2025. godine.**
- Apliciranje se može obaviti onlajn (**https://hris.bqk-kos.org**) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi oblici apliciranja neće biti razmatrani.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Zhvillues/e i/e aplikacioneve në Sharepoint (Zyrtar i lartë)
**Grada:** P05
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar
**Departamenti:** Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë
**Divizioni:** Për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Projektimi dhe zhvillimi i aplikacioneve të personalizuara, duke përdorur Power Apps për të përmirësuar proceset e biznesit dhe përvojën e përdoruesve.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e rrjedhave të automatizuara të punës me Power Automate për të reduktuar detyrat manuale dhe për të integruar sisteme si SharePoint dhe API-të e jashtme.
- Ndërtimi dhe menaxhimi i faqeve, librarive, listave dhe autorizimeve në SharePoint për të mbështetur bashkëpunimin dhe menaxhimin e dokumenteve.
- Integrimi i të dhënave nga burime të ndryshme, duke përfshirë Dataverse, databaza SQL dhe API-të e jashtme, duke siguruar saktësinë, sigurinë dhe pajtueshmërinë e të dhënave.
- Kryerja e testimeve, zgjidhja e problemeve dhe optimizimi i aplikacioneve, rrjedhave të punës dhe integrimeve të të dhënave për të zgjidhur çështjet dhe për të përmirësuar performancën.
- Bashkëpunimi me palët e interesit të biznesit për të mbledhur kërkesat, për të ofruar trajnime dhe për të dokumentuar zgjidhjet për mirëmbajtje të vazhdueshme.
- Qëndrimi i përditësuar me përditësimet e Microsoft Power Platform, praktikat më të mira dhe teknologjitë e reja për të rekomanduar përmirësime.
- Shkrimi i query-ve të avancuara për analizën e të dhënave dhe përpunimin e tyre sipas nevojave të biznesit.

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**

- Diplomë universitare (bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose një nga certifikimet e mëposhtme:
  - Microsoft Certified: Power Platform Fundamentals (PL-900);
  - Microsoft Certified: Power Platform Functional Consultant Associate (PL-200);
  - Microsoft Certified: Power Platform Developer Associate (PL-400);
  - Microsoft Certified: Power Platform Solution Architect Expert (PL-600).
- Së paku 3 vite përvojë pune në zhvillimin e zgjidhjeve me SharePoint, Power Apps dhe Power Automate.
- Gjuha angleze - e preferuar;

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **26 dhjetor 2025.**
- Aplikimi mund të bëhet online (**https://hris.bqk-kos.org**) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Pozicija:** Programer/ka aplikacija SharePoint (Viši službenik)
**Stepen:** P05
**Trajanje zaposlenja:** na neodređeno vreme
**Odeljenje:** Informacione tehnologije i bezbednosti
**Odsek:** Za upravljanje bazama podataka i aplikacijama
**Izveštava:** Rukovodiocu odseka za upravljanje bazama podataka i aplikacijama

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Dizajniranje i razvijanje personalizovanih aplikacija, koristeći Power Apps za poboljšanje poslovnih procesa i iskustava korisnika.
- Kreiranje i održavanje automatizovanih tokova rada pomoću Power Automate-a kako bi se smanjio broj manualnih zadataka i integrisanje sa sistemima kao što je SharePoint i eksterni API.
- Kreiranje i upravljanje stranicama, bibliotekama, listama i dozvolama u SharePoint-u radi podrške saradnji i upravljanju dokumentima.
- Integrisanje podataka iz različitih izvora, uključujući Dataverse, baze podataka SQL i eksterne API-je, obezbeđujući tačnost, bezbednost i usklađenost podataka.
- Sprovođenje testiranja, rešavanje problema i optimizacija aplikacija, tokova rada i integracija podataka radi rešavanja problema i poboljšanja performanse.
- Saradnja sa poslovnim zainteresovanim stranama radi prikupljanja zahteva, održavanja obuka i dokumentovanja rešenja za kontinuirano održavanje.
- Ostati ažuriran sa ažuriranjima Microsoft Power Platform, najboljim praksama i novim tehnologijama radi preporučivanja poboljšanja.
- Pisanje naprednih query-ja za analizu i obradu podataka shodno potrebama biznisa.

**Kvalifikacije i potrebno iskustvo:**

- Univerzitetska diploma osnovnih studija iz računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili jedan od sledećih sertifikata:
  - Microsoft Certified: Power Platform Fundamentals (PL-900);
  - Microsoft Certified: Power Platform Functional Consultant Associate (PL-200);
  - Microsoft Certified: Power Platform Developer Associate (PL-400);
  - Microsoft Certified: Power Platform Solution Architect Expert (PL-600).
- Najmanje 3 godine iskustva u razvoju rešenja sa SharePoint-om, Power Apps-om i Power Automate-om.
- Poznavanje engleskog jezika - poželjno;

**Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:**

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Motivaciono (propratno) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka)
- **Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PAK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, pri čemu diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi kao dokaz o državljanstvu Kosova;

**Procedura apliciranja:**

- Zadnji rok za apliciranje je **26 decembar 2025. godine.**
- Apliciranje se može obaviti onlajn (**https://hris.bqk-kos.org**) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi oblici apliciranja neće biti uzeti u obzir.


100% Fresh & Natural
VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME FINESË DHE DASHURI
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES
95 g